VENDIM
Nr. 439, datë 26.6.2019

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2019, PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor", dhe të nenit 18, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor "Shërbimet e kujdesit parësor", në artikullin 604, "Të tjera transferime korrente të brendshme", të pakësohet fondi prej 749 300 000 (shtatëqind e dyzet e nëntë milionë e treqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor "Shërbimet e kujdesit dytësor", në artikullin 604, "Të tjera transferime korrente të brendshme", të shtohet fondi prej 749 300 000 (shtatëqind e dyzet e nëntë milionë e treqind mijë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe